

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“RRJOLL LAGOON”**

**KAPITULLI I  
EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**Neni 1  
Themelimi**

Sot, më datë 25.06.2024 në Tiranë, Shqipëri.

1. Emri i shoqërisë është “**RRJOLL LAGOON**” sh.p.k këtu më poshtë e quajtur “Shoqëria”.
2. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
4. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2  
Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

➤ **Rruga Nacionale Tirane Elbasan , tek qendra Lobby Home, perballë Qendres Tregtare Teg, Zone Kadastrale 2529, Nr Pasurie 568/14+568/27,**

-Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjera, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

**Neni 3  
Objekti**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

*-Aktivitet ne fushen e investimeve per ndertim dhe menazhim strukturash turistike akomoduese e restorante. Aktivitet ne fushen e tregtise: tregti me shumice dhe pakice i artikujve te ndryshem ushqimore, pijeve alkolike dhe analkolike dhe gjithcka perfshin gama e artikujve ushqimore, tregtimi me shumice dhe pakice i artikujve industriale, pajisjeve hidrosanitare, artikujve elektrike dhe elektroshtepiake, materiave te ndertimit.*

-Shoqeria do të jetë në gjendje të kryejë të gjitha transaksionet tregtare, industriale dhe financiare, jo kryesisht, letrat me vlerë, pasuritë e paluajtshme, me sqarimet e përmendura në paragrafin e fundit të këtij nen, të gjykuara nga organi administrativ i nevojshëm ose i dobishëm për të arritur qëllimin e shoqerise. Shoqeria mund të japë hua dhe siguri dhe çdo garanci tjetër reale ose personale gjithashtu për detyrimet e palës së tretë, të marrë aksione ose interesa në shoqeri dhe biznese të tjera për sa kohë që ata kanë një objekt të ngjashëm ose të lidhur me të drejtpërdrejt ose indirekt. Të gjitha jo drejt publikut dhe jo kryesisht. Shoqeria mund të punësojë dhe të japë përfaqësues dhe agjenci, duke përfshirë kompani të huaja, në lidhje me shërbimet dhe produktet e trajtuarë.

Kompania gjithashtu do të jetë në gjendje të ndërtojë dhe blejë ndërtesa industriale, rurale dhe banimi, për përdorim të drejtpërdrejtë dhe gjithashtu për t'i dhënë ato me qira.



**Neni 4**  
**Kohëzgjatja**

-Kohëzgjatja e shoqërise do të jetë për një periudhë të pacaktuar

**KAPITULLI II**  
**KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR; KONTRIBUTET, KUOTAT –PJESET E KAPITALIT**

**Neni 5**  
**Kapitali Themeltar dhe Ortaket**

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 ALL (njeqind lek). Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaket e mëposhtëm:

- Shoqëria "BRUNES" shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K37125203H, me adresë Godine 2 Kateshe (Shoëroom+magazine) Perballe Komunes Xhafzotaj, Kati 1, Zona Kadastrale 2574, Nr Pasurie 163/42, Stacioni Zooteknik Xhafzotaj, përfaqësuar nga Administratori Z.Geront Çela, atësia Teki, amësia Metullahe, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Ismail Qemali; Nd. 18; H. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 14/08/1968, gjëndja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar prej meje me Letërnjoftim ID Nr. 028351328 dhe Nr. Personal G80814092M, ne kuoten 100%;

2. Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyhet plotësisht me kontribute në para nga ortaket.

**Neni 6**  
**Transferimi i Pjesëve – Kuotave**

Çdo ortak mund t'ia transferojë pjesët e tij në kapitalin e Shoqërisë çdo pale të tretë me komunikim ndaj ortakeve te tjere nepermjet letre rekomande, oferten e marre, duke treguar emrin e bleresit te mundshem dhe kushtet e tjetersimit, ne menyre te veçante çmimin e percaktuar dhe menyren e pageses. Ortakët e tjerë duhet t'i përgjigjen njofimit të Ortakut transferues nëse dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes, me të njëjtat kushte, brenda një periudhe prej 30 ditësh. Në rast të një përgjigjeje negative ose nëse Periudha e Njoftimit kalon pa përgjigje, Ortaku transferues mund të procedojë me transferimin e pjesëve te pala e tretë.

**KAPITULLI III**  
**ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

**Neni 7**  
**Asambleja e Përgjithshme**

1 Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakort me këto vendime.  
2 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:



Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikqyr zbátimin e këtyre të fundit nga administratori;  
Emeron dhe shkarkon administratoret;  
Percakton shperblimin e administratoreve;  
Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori;  
Merr vendimin pér ndryshimet Statutore;  
Merr vendim pér zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;  
Merr vendimin pér shpérndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;  
Merr vendimin pér riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;  
Merr vendim pér cdo ceshtje tjeter te parashikuar nga ligji.

### **Neni 8** **Thirrja e Asamblese**

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mund te thirret nga Administratori(ret) apo secili prej Ortakeve me njoftim derguar ortakeve ne vendbanimin e tyre ose ne adresen e postes se tyre elektronike dhe i marre prej ketyre te pakten 7 (shtate) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e asamblese. Ne njoftimin e thirrjes duhet te tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e çeshtjeve ne rend te dites.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqerise ose diku tjeter brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, ose me telekonferencë.

Asambleja e Pergjithshme shprehet ne menyre te vecante per cdo ceshtje te rendit te dites , per te cilën duhet te merret një vendim I vecante.

Ortaket mund te marrin pjese ne Asamblene e Pergjithshme personalisht ose nepermjet perfaqesuesit te autorizuar me procure. Administratori (et) e shoqerise nuk mund te perfaqesojne Ortaket ne Asamblene e Pergjithshme

### **Neni 9** **Procesi i vendimmarrjes**

Asambleja e Përgjithshme mblidhet sipas nevojës, por në çdo rast të paktën një herë në vit.  
Asambleja e Përgjithshme quhet e mbledhur rregullisht kur jane të pranishëm te dy Ortaket, me kutoten 80% dhe 20%. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet pér 30( tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë, në lidhje me çeshtje pér të cilat ligji nuk kërkon një shumicë të cilësuar përcaktuar në pikën 9.4 si më poshtë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar prej  $\frac{3}{4}$  e votive te ortakeve te pranishem ne lidhje me:

Ndryshimin e Statutit;  
Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit  
Shpérndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;  
Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë

**Neni 10**  
**Administratori**

1. Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
2. **Administrator i shoqerise eshte:**  
*Znj. Ada Kopaçi me numer personal J16017087M, mandati i te cilit do te jete per nje afat 5 vjecar nga data 25.06.2024 deri me 25.06.2029.*  
Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori. Administratori ka të drejtë të leshojë prokura apo autorizime të veçanta, pervecse kur parashikohet ndryshe;
3. Administratori ka te drejtat dhe detyrimet e meposhtme:

- Administrimin e veprimitarise se Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme;
- Perfaqesimin e Shoqerise ne marredhenie me cdo pale te trete;
- Marrien e masave per hartimin dhe mbajtjen ne menyren e duhur te pasqyrave financiare dhe te dokumenteve;
- Pergatitjen dhe nenshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve te konsoliduara, pergatitjen e raportit te ecurise dhe dorezimin e ketyre te fundit bashke me propozimin perkates per shperndarjen e fitimeve Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- Dorezimin ne Qendren Kombetare te Biznesit te dokumentave dhe te te dhenave te shoqerise, pavec rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
- Raportimin ne Asamblene e per gjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare te shoqerise dhe ne lidhje me permbushjen e transaksioneve te nje rendesie te vecante per ecurine e Shoqerise;
- Kryerjen e cdo detyre tjeter te parashikuar nga ligji ose nga ky statut;
- Administratori mund te autorizoje nepermjet nje procure nje pale te trete te perfaqesoje Shoqerine dhe te nenshkruaje cdo document, kerkesa ose aplikim ne emer dhe per llogari te shoqerise.
- Administratori eshte perjegjes ndaj shoqerise per cdo dem te shkaktuar si pasoje e mosperm bushjes se detyrimeve te parashikuara nga dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacioni ne fuqi.

Kufizimet e administratorit:

- Administratori nuk ka te drejte te nenshkruaj marreveshje/kontrata që kanë të bëjnë me të gjitha veprimet juridike mbi pasuritë e paluajtshme. Në përputhje dhe vazhdim të këtij përcaktimi, çfarëdo veprimi juridik që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme, nuk do të ketë fuqi juridike nëse është nënskruar nga administratori pa nje vendim asambleje nga ortaku I shoqerise.
- Administratori nuk ka te drejte te kryeje asnje veprim bankar prane institucioneve bankare, duke perjashtuar ketu veprimet që kanë të bëjnë me pagesat, ku mjafton vetëm firma e administratorit.

**KAPITULLI IV**  
**VITI FINANCIAR- SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 11**  
**Viti finanziar**

Viti finanziar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.



### **Neni 12**

#### **Shpërndarja e fitimeve**

Fitimi i dekluaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë do të shpërndahet midis ortakut/ortakëve, në raport me kuotat e zotëruara.

Fitimi mund t'u shpërndahet ortakut/ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividentit:

- a. aktivitetet e shoqërisë mbulojnë tëresisht detyrimet e saj;
- b. shoqëria aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

### **KAPITULLI V**

#### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 13**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për prishjen e shoqërisë, do të emërohen një ose më shumë likuidues.

### **KAPITULLI VI**

#### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 14**

#### **Ligji i Zbatueshëm**

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqërinte tregtare

### **Neni 15**

#### **Të ndryshme**

Ky Akt-Themelimi dhe Statut është hartuar dhe nënshkruar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe

#### **THEMELUES**

Shoqeria "Brunes" shpk  
Administrator: Z. Geront ÇELA


